



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	02-09	2022	2	viti god. year
Organ / Mjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDM8HKK	5798/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.665/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca- kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.665/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë
banimi të datës 22.07.2022
të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "*transferim i përkohshëm*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 02.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.665/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesja**
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.02-112/02-0060474/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës.**
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Podujevës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kthejë ankuesen në pozitën "*Inspektore për Ndërtim*" sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 26.07.2022 ka
parashtruar ankesë me numër protokoll 4314/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.02-112/02-0060474/22 të datës 22.07.2022 të

Kryetarin të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, me bazë ankimore që i njëjti të anulohet si i paligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.07.2022 ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më datë 08.08.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4314/2022 të datës 26.07.2022; Vendimin me numër 02-112/02-0060481122 të datës 22.07.2022 për transferim të përkohshëm; Vendimin me numër Nr.02-112/02-0060474/22 të datës 22.07.2022 për Kryetarin të Komunës së Podujevës lidhur me transferimin e përkohshëm; Akt Emërimit e datës 01.07.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4424/2022 të datës 29.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4590/2022 të datës 08.08.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën " Inspektor i ndërtimit" Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 21.07.2022; Kërkesën e datës 20.07.2022 për transferim; Pëlqimin për transferim të datës 22.07.2022; Diplomën Universitare me NR.984 të datës 08.02.2010 të ankueses; Emalin zyrtarë e datës 26.07.2022 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 26..07.2022 te drejtuar , Emalin zyrtar të datës 22.07.2022 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2019 është e punësuar në pozitën e punës "Inspektore e Ndërtimit" në Drejtorinë për Inspeksion pranë Komunës së Podujevës. Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 ka nxjerr Vendimin Nr.02-112/02-0060474/22 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozita e punës "Inspektore e Ndërtimit" në pozitën e punës "Zyrtar për Ndërtimtari".

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke shtuar së ky vendim është marrë nga personi jo kompetent, nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit, dhe se nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor lidhur me kompetencën e organit për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund*



të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe rrjedhimisht vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji i Këshillit konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetence të njësisë përgjegjëse.

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në kuadër të administratës lokale është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankueses nga pozita e punës "Inspektore e Ndërtimit" në pozitën e punës "Zyrtar për Ndërtimtari" nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe rrjedhimisht nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsyetim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga Kryetari i Komunës. Andaj meqenëse vendimi i kontestuar, gjegjësisht Vendimi Nr.02-112/02-0060474/22 i datës 22.07.2022 për transferimin e përkohshëm të ankueses është nxjerr nga Kryetari i Komunës dhe jo nga Njësia e Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit vlerëson se akti i kontestuar është nxjerr nga organi jo kompetent dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar dhe i ligjshëm.

Kolegji i Këshillit, po ashtu nga vlerësimi i Vendimit Nr.02-112/02-0060474/22 të datës 22.07.2022 për transferim të përkohshëm të ankueses ka gjetur se me vendimin në fjalë nuk është saktësuar kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm, veprim ky në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe dispozita e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se vendimi i kontestuar nuk përmban elementet e aktit administrativ siç kërkohet më nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar konstatoi së i njëjti përmban vetëm pjesën hyrëse dhe dispozitivin, ndërsa nuk përmban pjesën arsyetuese dhe këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku shprehimisht është theksuar se:

1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e



hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbajtëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”, kështu që pretendimi ankimor i ankueses mbi këtë bazë është ligjërisht i drejtë dhe i bazuar.

Andaj, bazuar si me sipër dhe duke marr parasysh së një akt administrativ i nxjerr nga organi jo kompetent, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, dhe duke mos u respektuar elementet e detyrueshme të aktit administrativ është akt administrativ i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.665/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

